



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 18 MAJ 2023, TIRANË

**PROCESVERBAL**

**SEANCËN E DREJTON**  
**KRYETARJA E KUVENDIT**  
**LINDITA NIKOLLA**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 13.04.2023 *(neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)*

2. Njoftime *(neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)*

3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (agjencia e zbatimit të projektit) për projektin “Zhvillimi i integruar rajonal”” *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim)*

Koha e votimit

4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana” *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim)*

Koha e votimit

5. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

*(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit, çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)*

**Lindita Nikolla** – Mirëdita!

Hapim seancën plenare.

Në bazë të nenit 30 të Rregullores, ju bëj të njohur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

*(Pasi lexon rendin e ditës.)*

Fillojmë me çështjet sipas rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 13 prill 2023. A ka vërejtje për procesverbalin, të cilin e keni marrë në rrugë elektronike? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te njoftimet.

Ju njoftoj se në Kuvend janë depozituar 6 akte nga Këshilli i Ministrave, 1 akt normativ dhe 1 projektligji i propozuar nga deputetët.

Titujt e çështjeve të depozituara i gjeni në sistemin elektronik në sallë, ndërsa materialet në sistemin “e-Parlament” dhe në faqen e Kuvendit në internet.

Ju njoftoj se sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila miratoi me mirëkuptim programin e punimeve të Kuvendit për periudhën 22 maj – 30 qershor 2023, si dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 22 maj – 9 qershor 2023.

Ju njoftoj se nga KQZ-ja është depozituar në Kuvend vendimi nr. 431, datë 03.05.2023, “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Shkodër, zotit Frrok Gjini” pas krijimit të vakancës në Kuvend, për shkak të dorëheqjes së zotit Benet Beci nga mandati i deputetit.

Sot, në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, është mbledhur Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të verifikuar mandatet e deputetëve të zgjedhur nga KQZ-ja. Raportin do ta paraqesë zonja Bushka.

Zonja Bushka, fjala për ju.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Sot është mbledhur Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për verifikimin e mandatit të deputetit, zotit Frrok Gjini, i ardhur nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Shkodër.

Kuvendi, në mbështetje të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të njoftuar vakancën e krijuar pas dorëheqjes së zotit Benet Beci nga mandati i deputetit. Për shkak të njoftimit të vakancave,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 431, datë 03.05.2023, i ka dhënë mandatin e deputetit kandidatit vijues të listës shumemërore të Partisë Socialiste, zotit Frrok Gjini. Pas verifikimit që iu bë mandateve të fituara dhe pas krahasimit me legjislacionin e aplikueshëm, rezultoi se në vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë respektuar kërkesat e parashikuara në nenet 69, 70 dhe 71 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket procedurës së dhënies së mandatit, është respektuar neni 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, sipas të cilit mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues të listës të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, si dhe është ruajtur balanca e gjinisë së përfaqësuar.

Në konkluzion: Këshilli vlerësoi se për deputetin, zotin Frrok Gjini, nuk rezultoi asnjë paligjshmëri në zgjedhje që ta pengojë atë për të bërë betimin në seancë plenare. Për pasojë, zoti Frrok Gjini, i cili ka fituar mandatin e deputetit, në mbështetje të nenit 4, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, ftohet për të bërë betimin në seancën plenare të Kuvendit, si kusht për të filluar ushtrimin e mandatit të deputetit.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zonja Bushka!

Ashtu siç jeni në dijeni, në datën 13.04.2023 është zhvilluar mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, ku u verifikuan mandatet e deputetëve të zgjedhur nga KQZ-ja: zoti Shkëlqim Bullari, zoti Asllan Dogjani, zoti Ludovik Hasani dhe zoti Qani Xhafa. Raporti i Këshillit u paraqit në seancën plenare të datës 13.04.2023. Pasi u paraqit raporti në seancë, bëri betimin vetëm zoti Shkëlqim Bullari.

Në mbështetje të nenit 72 të Kushtetutës dhe të nenit 4, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, kam ftuar për të bërë betimin deputetët e rinj: zotërinjtë Asllan Dogjani, Ludovik Hasani, Qani Xhafa dhe Frrok Gjini. Në mbështetje të nenit 4, pika 3 e Rregullores së Kuvendit, unë do të lexoj tekstin e betimit, ndërsa deputetët e rinj, zoti Asllan Dogjani, zoti Ludovik Hasani, zoti Qani Xhafa dhe zoti Frrok Gjini, do të ngrihen në këmbë dhe do të deklarojnë “Beto hem”, pasi unë t’u thërras emrin.

Teksti i betimit: “Betohe në nderim tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend, do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t’u bindem Kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj dhe do të mbroj të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe do të punoj me të gjitha fuqitë e mia për përparimin e Atdheut dhe mirëqenien e popullit”.

Zoti Dogjani?

**Asllan Dogjani** – Betohe.

**Lindita Nikolla** – Zoti Hasani?

**Ludovik Hasani** – Betohe.

**Lindita Nikolla** – Zoti Xhafa?

**Qani Xhafa** – Betohe.

**Lindita Nikolla** – Zoti Gjini?

**Frrok Gjini** – Betohe.

**Lindita Nikolla** – Suksese!

Vijojmë me rendin e ditës.

Sot në rendin e ditës kemi dy projektligje: projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (agjencia e zbatimit të projektit) për projektin “Zhvillimi i integruar rajonal”” dhe projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana”.

Ju bëj me dije që të dyja projektligjet janë diskutuar në seancën e datës 13 prill dhe procesi i votimit u shty për seancën pasardhëse, për rrjedhojë procesi i votimit do të zhvillohet sot.

Ju lutem, bëhuni gati për votim!

Kalojmë në procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Të nderuar deputetë, ju lutem, votoni!

Mbyllet votimi për prezencën.

108 deputetë prezentë.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (agjencia e zbatimit të projektit)” për projektin “Zhvillimi i integruar rajonal”.

Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, 5 abstenim, 29 kundër.

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, 1 abstenim, 28 kundër.

Miratohet projektligji në tërësi.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana”.

Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim.

Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

99 vota pro, 1 abstenim, asnjë kundër.

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

97 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

Miratohet projektligji në tërësi.

Këtu mbyllet procesi i votimit.

Vazhdojmë me diskutimet për çështje jashtë rendit të ditës.

Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit, çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit parlamentar jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.

Zonja Kumbaro, keni fjalën.

**Mirela Kumbaro** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Po e përdor me shumë kënaqësi këtë hapësirë për të bërë një falënderim shumë të madh për të gjithë banorët, votuesit, të mëdhenj e të vegjël të qarkut më të bukur, atij të Gjirokastrës, që e mbështeti qartazi Partinë Socialiste dhe besoi te kandidatët e saj, duke qenë ndër dhjetë bashkitë me rezultatin më të lartë në rang kombëtar. Pra, ndër këto dhjetë bashki me këtë rezultat, katër ishin nga qarku i Gjirokastrës.

Faleminderit Gjirokastra, Libohova, Dropulli, Tepelena, Përmeti, Këlcyra, madje edhe Memaliaj, ku këshilli bashkiak mori shumicën e votave të PS-së!

Shumë faleminderit, të nderuar kolegë kolegë opozitarë.

Shumë faleminderit, kolegë të mi të Partisë Socialiste!

Ne, pasi të mbarojmë duartrokitjet, kemi nevojë të vazhdojmë, sepse na presin shumë punë të tjera. Puna vazhdon, kantieri vazhdon. Vetëm përpara!

**Lindita Nikolla** – Zoti Dashnor Sula nuk është. Konsiderohet se është tërhequr.

Zoti Sali Berisha nuk është. Konsiderohet se është tërhequr.

Zoti Oerd Bylykbashi nuk është.

Elisa Spiropali?

Dakord.

Zonja Belinda?

Zoti Noka, do të flisni?

**Flamur Noka** – Sot është një ditë kur çdo shqiptar i ndershëm duhet të jetë kryeulur kur analizon dhe shikon që para 2 ditësh u mbyll procesi më i turpshëm në historinë e Shqipërisë për sa u përket të ashtuquajturave “procese zgjedhore”. Ditën e diel, në datën 14 maj, në Shqipëri nuk kishte zgjedhje, por kishte thjesht një proces votimi. Ditën e diel ju konfirmuat se këtu nuk ekziston një qeveri demokratike, sikundër duhet të ketë në çdo vend me demokraci të konsoliduar. Dita e diel konfirmoi se në Shqipëri ka një regjim, një narkoregjim. Ditën e diel u tregua se në Shqipëri vija ndarëse mes partisë, pushtetit dhe shtetit nuk ekziston. Në Shqipëri parti-shtet ishin të gjithë: krimi, paraja e kimit, paraja e korrupsionit, paraja e drogës Shërbimi Informativ, policia, ushtria ishin garnizon i Partisë Socialiste për të blerë, për të

vjedhur, për të dhunuar, për të terrorizuar dhe për të përçudnuar procesin e quajtur “zgjedhor”, vetëm e vetëm me një kusht: “Rilindja” të merrte 100% të pushtetit. Pra, banda, e quajtura “qeveri”, ditën e diel shkoi në zgjedhje me një moto: “Të gjithë pushtetin sovjetëve!”. Nuk kishte gjë më të neveritshme. Nuk kishte asnjë arsye që në Shqipëri të ndodhte një gjë e tillë, por pse? Sepse kjo tregon mentalitetin. Edi Rama dhe kjo qeveri kanë një mentalitet obskurantist. Nuk ishte imagjinuar ndonjëherë që Kryeministri t’u thoshte shqiptarëve: “Po votuat opozitën, do t’u lëmë pa ujë, pa bukë dhe pa drita”. Kjo gjë kalon edhe kufijtë e njerëzores, se të politikës po e po. Jeni duke e çuar Shqipërinë në skajet e të pamundurës për të duruar, jeni duke u thënë shqiptarëve që ne ju shkelim dhe ju konsiderojmë si vemje. Këta mekanizma që keni përdorur ju, i përdor vetëm mafia. Nuk ka vend në botë, ku një pushtet përdor instrumente të tilla kriminale, antiligjore, vetëm e vetëm për të marrë bashkitë. Elbasani e tregoi qartësisht këtë. Çfarë bëtë në Belsh me të burgosurit, duke i vënë të votojnë nga tri-katër herë?! I merrnit nga Durrësi për të votuar në Rrogozhinë. I çonit të votonin në Belsh vetëm e vetëm që i gjithë pushteti t’u kalonte sovjetëve. Pra, ju përfundimisht, Edi Rama, kjo qeveri dhe kjo “Rilindje” nuk takoheni asgjekund me votën e lirë. Nuk keni kurrfarë pikëtakimi me të. Jeni një regjim kriminal, kështu që bëhuni gati, sepse do t’ju përgjigjemi, ashtu siç e meriton një regjim kriminal dhe një bandë kriminale. Nuk ka më asnjë rrugë tjetër me ju. Nuk ka shqiptar që nuk e provoi. Shkoi kursi i euros 100,09 lekë. A jeni në vete?! Kurrë nuk ka rënë kursi i euros në këtë nivel. Po çfarë ishte kjo? Më e pakta ishin 500 milionë euro të korrupsionit tuaj dhe të kimit, që u hodhën. Pse? Për të vrarë votën e lirë. Juve nuk ju lidh asgjë me demokracinë e me votën e lirë, ndaj prisni përgjigjen. Përgjigjja do të jetë ajo që meriton çdo bandë, qoftë me pushtet e qoftë pa pushtet.

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Bujar Leskaj. Më pas fjalën e ka zoti Vangjel Dule.

Pesë minuta, zoti Leskaj!

**Bujar Leskaj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Vetëm në Kuvendin e Shqipërisë mund të ndodhë kjo, që tri ditë pas një maskarade zgjedhore salla e Kuvendit të jetë bosh. Megjithatë, të nderuar deputetë, sot duhet të

pohojmë se është shumë i trishtë fakti që më 14 maj 2023 Shqipëria dështoi në përpjekjet për të zhvilluar zgjedhje vendore të standardit evropian në një fushatë të dominuar nga Partia Socialiste-shtet. Simptomat e partisë-shtet kanë qenë të dukshme vite më parë, por në gjysmën e dytë të vitit 2022 dhe në pesë muajt e parë të këtij viti, sipas mendimit tim, ato u shtuan dhe u përqendruan vetëm në një objektivi: deformimin e vullnetit të lirë të qytetarit para kutisë së votimit, bazuar në përvojën e keqe për Shqipërinë, por në përvojën e suksesshme për Partinë Socialiste në zgjedhjet e përgjithshme të prillit të vitit 2021.

Më 14 maj “sekti Rama” në qeverisje, përmes qindra mënyrave të kamufluara e të hapura, vrau një nga të drejtat themelore të qytetarëve: të drejtën për të zgjedhur të lirë përfaqësuesit e tyre në pushtet. Gjithçka në këtë ngrehinën e madhe “Rama”, në strukturat qendrore në qendër e në bashki, funksionoi vetëm për deformimin e votës në garën zgjedhore. Stafet e të 60 bashkive dhe të ndërmarrjeve në varësi të tyre, në duart e socialistëve, u frynë artificialisht me dhjetëra e me qindra vetë, të cilët u punësuan veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022 dhe gjatë pesë muajve të parë të këtij viti. Jo vetëm qytetarëve të thjeshtë, por edhe sipërmarrësve që nuk mendonin si “sekti” në pushtet, si alternativë e vetme për mirëqenien e tyre dhe të një jete me dinjitetiu la braktisja e vendit. Në dy vjetët e fundit janë 200 mijë shqiptarë që kanë braktisur Shqipërinë (shumica dërrmuese janë simpatizantë dhe votues të opozitës) dhe këtë nuk e thekson asnjë nga të paguarit tuaj në mediet qendrore dhe vendore. Armata e mijëra aktivistëve dhe patronazhistëve gjeti strehë dhe punësim në dhjetëra sh.a. shtetërore, të cilat tashmë e meritojnë epitetin “anonime”, në dikastere qendrore dhe në ndërmarrje shtetërore të periferisë. Ata u inkuadruan si aktivistë të organizatave joqeveritare, me projekte të fituara gjoja me meritë në AZHBR-në e Ministrisë së Bujqësisë apo me thirrje për projekte të hapura me paratë e buxhetit të shtetit në dikastere të tjera, si: Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit e të tjera. Këta mijëra aktivistë dhe patronazhistë trokitën e trokitën për ditë e javë të tëra, duke ushtruar presionin e tyre në deformimin e votës së lirë.

Por më e keqja dhe më flagranta është se sekta “Rama”, edhe me ndihmën e përfaqësuesve të botës së kimit dhe të trafikëve, deformoi dhe,

praktikisht, vrau barazinë para ligjit, duke zeruar të drejtën themelore të qytetarëve për të votuar të lirë. Vetëm në muajt e fundit, përpara votimit më 14 maj, qarkulluan në ekonominë shqiptare rreth 300 milionë euro të trafikëve, të vërtetuara këto në një lidhje shkak-pasojë me rënien e theksuar të vlerës së këmbimit të euros në tregun valutor në Shqipëri, gjë që asnjë nga pasionantët tuaj nuk e shpjegon dot. Kjo rënie e paprecedentë në ekonominë e tjera të rajonit, të ngjashme me tonën, përbën faktin e qartë dhe të pamohueshëm të përdorimit të fondeve të narkotikëve dhe të trafikëve të tjera të paligjshme për interesat dhe aktivitetet e fushatës zgjedhore nga narkoshteti i Ramës. Sapo mbaroi fushata (jemi dëshmitarë), euro filloi të rritej.

Ju dhe lideri juaj global e keni përdhosur dhe e keni shkatërruar shtetin e së drejtës, keni shkelur gjatë zgjedhjeve çdo ligj dhe çdo kod etik, që nuk lejojnë përdorimin e buxhetit dhe të arkës së shtetit për premtime dhe për dhënie fondesh përpara zgjedhjeve apo programe dhe premtime për rritje 1-vjeçare pagash më pak se një muaj përpara garës zgjedhore, si dhe përdorimin e drejtuesve të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore.

Kryetari i PD-së në Vlorë paraqiti para 3 javësh një kallëzim në organet përkatëse, ku argumentonte shpërdorimin e postit të zyrtarëve tuaj në Vlorë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë u vu në rolin e sigurueses së parave për megapremtimet përpara dhe gjatë fushatës, si bonusi prej 5 mijë lekësh për pensionistët në prill të vitit 2023 apo programi 1-vjeçar për rritjen e pagës mesatare në administratën publike, duke përfituar nga suficiti i të ardhurave buxhetore, edhe ky i shkaktuar nga rritja e çmimeve.

“Sekti” mbolli përçarjen në Kurbin ditët e fundit, në Vaun e Dejës në fillim të fushatës, si dhe në shumë bashki të tjera në Veri dhe në Jug, ndërsa falangat e IKMT-së së Ramës po përgatiten këto ditë pas zgjedhjeve që të hakmerren, duke goditur biznesin dhe ata që nuk iu bindën urdhrave dhe interesave të “sektit”.

Shembulli flagrant në Dhërmi duhet të na bëjë të gjithëve të na vijë turp se sa të dobët dhe vulnerabël janë qytetarët shqiptarë kur nuk votojnë sipas dëshirave të partisë në pushtet.

Krahas deformimit dhe blerjes së votës me mënyrën e mësipërme, fushata elektorale për

zgjedhjet vendore të vitit 2023 u zhvillua me mungesën e theksuar të seriozitetit dhe të llogaridhënies nga ata që janë në qeverisje. Zerimi i rivalitetit dhe krahasimi në ide dhe programe...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, mbarojeni, zoti Leskaj!

**Bujar Leskaj** – Edhe një minutë.

**Lindita Nikolla** – E keni kaluar një minutë.

**Bujar Leskaj** – Zonja Kryetare, nuk besoj se do të shqetësoheni edhe për 2 minuta.

Në rast se doni të ma ndërpritni fjalën, ndërpritni!

Krahas deformimit dhe blerjes së votës kjo fushatë u zhvillua në kushtet e një mungese të plotë llogaridhënieje. Zerimi i rivalitetit dhe krahasimi në ide dhe programe solli mungesë të vëmendjes së qytetarëve ndaj realizimit ose jo të premtimeve qeverisëse të socialistëve vendorë, fryrjen e stafëve të bashkive me aktivistë dhe patronazhistë në shkelje flagrante të çdo standardi të Kartës Europiane të Autonomisë Vendorë, abuzimet me tenderët vendorë, nepotizmin dhe korrupsionin.

Fushatës së zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 i munguan plotësisht transparenca dhe llogaridhënia, këto dy elemente më kryesore të një gare demokratike. Në vend të llogaridhënies takimet e pozitës me qytetarët morën formën e cirkut dhe të tallavasë, me gjuhën denigruese të Kryeministrit dhe elementet vizuale joetike të posterave të tij.

Keqpërdorimi, këtu po e mbyll, i institucioneve shtetërore dhe përdorimi i shfrenuar dhe pa kriter i fondeve shtetërore në shpërblime e rritje pagash për të blerë vota ka denatruar karakterin demokratik dhe të hapur të zgjedhjeve tona, duke i kthyer ato në tërësisht të manipuluar. Për këtë kemi përgjegjësi të gjithë.

Gjuha që Rama dhe klounët e tij përdorën në fushatë për të sulmuar rivalët dhe kundërshtarët politikë në zgjedhje, por jo kundërshtarët dhe armiqtë politikë, është bërë gjithmonë e më denigruese, arrogante dhe në mungesë totale të etikës dhe të seriozitetit. Dëshira e papërmbajtshme dhe e sëmurë për të denigruar dhe përcëmuar me çdo kusht kundërshtarin e ka çuar Ramën ta gërryëjë nga themelet shtetin e së drejtës në shoqëri dhe ju ta duartrokisni, deputetët e mazhorancës,...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, zoti Leskaj!

**Bujar Leskaj** - ...duke instaluar partinë-shtet si në pushtetin qendror, edhe në atë vendor klonet e një sektit të përbetuar, për t'i mjeruar akoma edhe më shumë shqiptarët dhe për të vazhduar projektin ogurzi të boshatisjes së Shqipërisë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Vangjel Dule.

Zoti Dule, keni 5 minuta.

**Vangjel Dule** – E nderuar Kryetare,

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Të nderuar qytetarë, kudo që gjendeni,

Jemi mësuar në proceset zgjedhore edhe me shpifjen, edhe me denigrimin, edhe me gjuhën e urrejtjes, edhe me manipulimin e rezultatit dhe kujtuam se i kishim parë të gjitha, por “sekti” në pushtet na surprizoi sërish, duke provuar që nuk njeh limite. Verbëria e arrogancës i çoi edhe deri në aktin që dëshmon tiraninë, arrestimin e kandidatit rival e më pas fituesin e zgjedhjeve. Kush nuk shkon pas ujërave të komandantit, ndëshkohet. Komuniteti që guxon të krijojë liri do ta paguajë, ndërsa ai që i prin komunitetit, në kërkim të demokracisë, burgoset. Kryetari i zgjedhur i Bashkisë së Himarës, zoti Fredi Beleri, është i burgosur politik, është rrëmbyer nga “sekti i Rilindjes”, është marrë peng nga Kryeministri Edi Rama. Të gjithë atyre, që mund të thonë që mos u nxito, lërja fjalën drejtësisë, unë u them: po, fjalën e ka drejtësia, por ka edhe një logjikë opinionit. Zoti Beleri është arrestuar në flagrancë për dyshime. Kushdo që di shqipen elementare e kupton se këtu kemi absurditetin më të madh. Flagranca presupozon faktin e kryer, ndërsa dyshimi është dyshim. Dhe, për të qenë i drejtë, po ju shpjegoj përse e cilësoj si pengmarrje nga Kryeministri Rama. A e dëgjuat t'u drejtohet drejtpërdrejt qytetarëve duke i kërcënuar se do ta ketë personalisht me ta? Si mund ta ketë një Kryeministër personalisht me disa qytetarë? A nuk ka institucione ky vend? Jo. Këtu çdo gjë është në duart e njëshit.

Prandaj, dëshiroj nga ky podium të drejtoj një thirrje të fundit: sot, tani, kreu i Bashkisë së Himarës, zoti Beleri, duhet të shkojë midis komunitetit himarjot, që e zgjodhi të parin e tij. Ata janë njerëz të guximshëm dhe kërkojnë lirinë. Janë njerëz të lirë, prandaj janë edhe të lumtur dhe nuk hezitojnë që për demokracinë të japin leksione.

Së dyti, dua t'i bëj të ditur çdo qytetari të ndershëm të këtij vendi, se, së bashku me zotën Beleri, është marrë peng edhe Pandeli Kokaveshi, në të njëjtat kushte, me të njëjtat akuza absurde, veçse për të kemi një dimension të skajshëm të mungesës së humanizmit: ai është një i ri që ka bërë transplant zemre. Pavarësisht se personalisht kam njoftuar autoritetet më të larta të Policisë së Shtetit dhe të drejtësisë, se qoftë edhe një sekondë më tepër të mbahet, jeta e tij është në rrezik, vazhdojnë ende ta mbajnë peng. Fatkeqësisht, nuk do ta besoni, por mentaliteti policor ka kaluar edhe të disa mjekë; arritje e paprecedentë e Rilindjes.

Prandaj, zonja dhe zotërinj, në Himarë, të vjetrit, gjatë të gjithë këtyre ditëve, më kujtonin vitin 1945, kur votuan kundër regjimit, por u syrgjynosën. Atëherë, në krye të atyre që u syrgjynosën ishte Spiro Koleka. Kush ka veshë dëgjon dhe kush ka intuitë kupton, - më tha një i moshuar i mençur, - po të paktën, zoti Dule, këtë herë nuk kemi pushkatime.

Së treti, IKMT-ja ka filluar aksione hakmarrëse. Objekti i Dhërmiut 001, dje ishte i rrethuar nga IKMT-ja, buldozerët dhe personeli. Një objekt i legalizuar, një objekt për të cilin shteti shqiptar ka vjelë të gjitha detyrimet e parashikuara në bazë të ligjit. Cili ishte mëkati i zotërisë së moshuar, pronar i këtij objekti? Është e thjeshtë, i biri kishte përmbushur një detyrë ligjore dhe kushtetuese, kishte qenë numëruar në zgjedhjet që zgjodhën fitimtar Fredi Belerin në Bashkinë e Himarës.

Ku po e çoni vendin, zotërinj?! Derisa do të vazhdoni ta mbështesni një autokrat, i cili po e fundos përditë edhe më tepër dhe po e zhyt vendin në errësirën e tiranisë?!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala është për zotën Taulant Balla. Keni 8 minuta në dispozicion.

**Taulant Balla** – Së pari, në cilësinë e kryetarit të grupit të shumicës në Kuvendin e Shqipërisë, në këtë seancë të parë pas përfundimit të zgjedhjeve vendore të vitit 2023 dua të falënderoj të gjithë zgjedhësit, qofshin të majtë, të djathtë, të qendrës, të të gjithë spektrit politik, të cilët morën pjesë në zgjedhje dhe shprehën vullnetin e tyre.

Natyrisht, më lejoni t'u shpreh një falënderim zemre të gjithëve atyre që u dhanë votën kandidatëve të Partisë Socialiste dhe si

asnjëherë tjetër edhe votën politike për këshillat bashkiakë në të 61 bashkitë e vendit. Nëse do t'u hedhim një sy rezultateve historike të këshillave bashkiakë, mendoj se ky është një rezultat i shkëlqyer, që na ka dhënë një shumicë pothuajse në të gjithë këshillat bashkiakë.

Natyrshtëm, ne nuk jemi sot këtu për të festuar, por jemi këtu për t'u thënë me shumë angazhim dhe me shumë përujje se do të dimë ta lexojmë me shumë vëmendje këtë mbështetje të madhe dhe këtë inkurajim, për të shkuar përpara.

Nuk dua të bëj asnjë lloj replike me askënd, qoftë me deputetin e fundit paraqolës, qoftë me shkopin që i ka ngelur pa flamur, i cili sapo foli në emër të asaj që ka mbetur nga foltorja e Sali Berishës, por ajo që dua të them, dua të jetë shumë e qartë për të gjithë opinionin publik. Mendoj se historia, që në këto vite gjithmonë humbësi e sheh fajin te kundërshtari dhe asnjëherë nuk bën një analizë të vetme për të kuptuar se çfarë ka bërë gabim, është të insistosh në të njëjtin gabim dhe kjo është një çmenduri, por le të vazhdojnë të insistojnë në të njëjtën qasje që kanë pasur!

Dua t'ju përsëjndes, kolegë deputetë që jeni në sallë dhe të informoj opinionin publik, në fakt, se e kemi nisur Kuvendin e Shqipërisë pas zgjedhjeve vendore me 2 vendime tepër të rëndësishme.

I pari lidhet me një investim, i cili i jep Shkodrës një lidhje të re dhe shumë të bukur me Ulqinin. Është ura mbi Bunë e cila, falë marrëveshjes që sapo kemi votuar, na jep mundësinë për diçka që ka munguar prej shumë kohësh dhe që jo vetëm lidh 2 qytete shqiptare në të dyja anët e kufirit, pra Ulqinin dhe Shkodrën, por i jep Shkodrës një qasje të re në një treg edhe më të madh të turizmit. Simbolika e këtyre zgjedhjeve, duke e konsideruar Shkodrën si një prej atyre fitoreve që na bën të ndihemi shumë të përgjegjshëm për punën e madhe që kemi përpara, është ta nisim pikërisht me një votim për një marrëveshje dhe për një investim të rëndësishëm në Shkodër.

Ndërkohë, pika tjetër e atyre që votuam sot lidhet me një marrëveshje me KfW-në, me qeverinë gjermane, të cilën gjithmonë gjej rastin ta falënderoj për gatishmërinë dhe disponibilitetin. Tanimë kjo lidhet me pjesën më të madhe të bashkive. Pothuajse të gjitha qarqet kanë akses në këtë marrëveshje të re që kemi me KfW-në për të përmirësuar infrastrukturën

rrugore, dhe jo vetëm, por edhe në sektorë të tjerë. Në këtë aspekt, mendoj se e kemi nisur këtë seancë të parë të Kuvendit të Shqipërisë me dy projektligje të rëndësishme për dy marrëveshje të rëndësishme.

Edhe pse opozita duket se e filloi punën me këtë lloj bojkoti të pranueshëm pas atij rezultati që ka marrë në zgjedhje, thirrja ime sot nga foltorja e Kuvendit të Shqipërisë është që opozita t'i rikthehet punës në Kuvend, pasi duhet të punojmë së bashku për një sërë çështjesh ku ka rëndësi bashkëpunimi mes mazhorancës dhe opozitës. Ne jemi të gatshëm të vijojmë bashkëpunimin tonë për çështje me rëndësi dhe do t'i kërkoj opozitës që të rifillojë menjëherë puna në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore për të adresuar të gjitha çështjet që janë pjesë e objektit të punës së Komisionit, që burojnë nga rekomandimet e raporteve të njëpasnjëshme të OSBE-ODIHR-it dhe, po ashtu, të përfundojmë në kohë edhe disa propozime të Partisë Socialiste, që lidhen me elemente të procesit zgjedhor.

Partia Socialiste i kërkon Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, por edhe Komisionit të Ligjeve, që të shqyrtojnë dhe të sjellin për votim në seancë "paketën e despiunizimit", siç e quajmë ne. Është e papranueshme që ne të vonojmë pastrimin e përfaqësimit politik nga elementë të caktuar, të cilët kanë shërbyer apo kanë qenë instrumente represivë të regjimit komunist dhe që mund të kenë penetruar edhe në këshillat bashkiakë, edhe në institucione të tjera. Kështu që, në këtë aspekt, mendoj se kemi shumë punë për të bërë.

Çështja e fundit që kam është thirrja për të përmbyllur procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Opozita duhet të kuptojë se nuk mund të mbajë peng zgjedhjen e një institucioni të rëndësishëm kushtetues, që ka të bëjë drejtpërdrejt me monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve, nëse do t'i referohemi përkufizimit kushtetues të rolit të Avokatit të Popullit. Kështu që, në këtë aspekt, që prej ditës së hënë, duke qenë se Kushtetuta na imponon një shumicë të cilësuar në zgjedhjen e Avokatit të Popullit, do t'i kërkojmë opozitës të ulemi për të dakordësuar kandidatin, i cili do të jetë Avokati i Popullit.

Shumë faleminderit të gjithë kolegëve për fillimin e mbarë të kësaj seance, sepse e vërteta ishte se për marrëveshjen për urën mbi Bunë, që

ndihmon shumë zhvillimin e turizmit në Shkodër dhe në Ulqin, ishim të gjithë bashkë, dhe ky është një ogur i mirë për t'i çuar para angazhimet që kemi ndërmarrë! Natyrshëm, besoj se edhe opozita do të dijë ta lexojë si duhet këtë rezultat. Ne e dimë fare mirë se ajo që kemi marrë më 14 maj nuk është një fitore, por është një përgjegjësi e madhe, që do të dimë ta lexojmë me vëmendje dhe kujdes kudo, do të dimë të bëjmë gjënë e duhur, sepse, në fund të fundit, vota është përgjegjësi.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

**Lindita Nikolla** - Mbyllet seanca.

Seanca e radhës do t'ju njoftohet.

Faleminderit!

Ditën e mirë!

*(Seanca u mbyll në orën 10:45)*

#### **Kryetarja e Kuvendit**

**Lindita Nikolla**

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtoresha e Shërbimit të Redaktorëve  
Suela Bala**